



Planuar / Doretuar Pimljen/Prodato Received/Delivery	19-06-2023	3	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shkruar Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	4839/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.703/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.703/2023 të datës 04.05.2023 të parashtruar nga ankuesja nga Prishtina, kundër organit të punësimit Institutit të Kosovës për Administratë Publike, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.06.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.703/2023 e datës 04.05.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Nëpunësja civile (*tutje ankuesja*) e punësuar në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, më datë 04.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të heshtjes dhe mosveprimit të organit të punësimit ndaj kërkesës së ankueses për kompensim për punët dhe përgjegjësitë shtesë që nga data 18.09.2013.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, ndërsa kjo e fundit me datë 12.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4028/2023 të datës 04.05.2023 të parashtruar nga ankuesja përmes e-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës;

Akt emërimin me nr.1879 të datës 18.09.2013; Kërkesën për kompensimin të datës 07.01.2023 e parashtruar nga ankuesja për Zëvendësuesin e Drejtorit të Përgjithshëm IKAP/MPB; Kërkesën për kompensimin në punë e datës 28.01.2019 e parashtruar nga ankuesja për Drejtoreshën e Përgjithshëm të IKPA-it; E-mail zyrtar i datës 09.06.2019-kërkesë për sqarim; E-mail zyrtar i datës 26.06.2019; E-mail zyrtar i datës 25.01.2023; Kërkesën për sqarim e datës 26.06.2019; E-mail i datës 05.02.2019; E-mail zyrtar i datës 09.07.2019; Kërkesën e datës 25.01.2023 e parashtruar nga ankuesja; E-mailin zyrtar i datës 01.02.2023-kërkesë; Përgjigje në ankesë e datës 12.05.2023 nga organi i punësimit; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën asistente ekzekutive të datës 06.01.2012; Vendimin A.nr.412/2023 të datës 15.03.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 24.02.2023 me numër protokolli 2045/2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesja është e punësuar në Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe se e njëjta nga data 18.09.2013 është emëruar dhe vazhdon të ushtroj pozitën e punës *Asistente Ekzekutive e Krye shefit Ekzekutiv* të Institutit të Kosovës për Administratë Publike.

Me tej nga provat e lëndës rezulton së ankuesja më datë 28.01.2019 kishte parashtruar kërkesë të organi i punësimit lidhur me kompensimin e punëve shtesë duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.08/2003 për Masat për Shtimin e Efikasitetit në Administratë Publike. Ankuesja për shkak të heshtjes se organit të punësimit në raport me kërkesën e saj për kompensim, e njëjta serish me datë 25.01.2023 parashtron kërkesë po me objekt dhe bazë të njëjtë ligjore, ndërsa me datë 24.02.2023, ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku ky i fundit me vendimin A.nr.412/2023 të datës 15.03.2023 ka hedhur poshtë ankesën si të palejuar me arsyetimin se ankuesja ende pa kaluar afati ligjor për vendosje nga organi i punësimit ka parashtruar ankesë në Këshill.

Ankuesja me datë 04.05.2023 parashtron serish ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të heshtjes dhe mosveprimit të organit të punësimit ndaj kërkesës së ankueses për kompensim për punët dhe përgjegjësitë shtesë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.08/2003 për Masat për Shtimin e Efikasitetit në Administratë Publike. Pretendon së përkundër kërkesave të ankueses, e njëjta nuk kishte arritur të realizoj kompensimin për punët shtesë që vazhdon ti kryej që nga data 18.09.2013, kështu që mos shqyrtimi i kërkesën për kompensim nga ana e organit të punësimit është veprim diskriminues sipas Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi. Propozon që këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të detyroj organin e punësimit që ankuesit t'i bëjë kompensim e shtesës në mënyrë retroaktive prej datës 18.09.2013 deri më datën 30.04.2023, dhe atë për vitin 2013 shumë prej 175 eurove, për vitin 2014-2022 shumë prej 5400 eurove dhe janar-prill 2023 shumë prej 200 eurove.

Kolegji i Këshillit shqyrtoj pretendimin ankimor të ankueses lidhur me kompensimin në mënyrë retroaktive për punët shtesë dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankueses si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedhë se ankuesja përkundër faktit të deklaruar në ankesë që disa herë kishte parashtruar kërkesë të organi i punësimit për kompensim lidhur me punët shtesë mbi bazën e Udhëzimit Administrativ Nr.08/2003 për Masat



për Shtimin e Efikasitetit në Administratë Publike, e njëjta nga nënshkrimi i Aktit të emërimit të datës 18.09.2013 e deri me datë 07.01.2023 (data e parashtrimit të ankesës së parë në Këshill) nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik-ankesë kundër heshtjes së organit të punësimit lidhur me kërkesën e ankueses për kompensim për punë shtesë, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesja është emëruar asistente ekzekutive e Kryeshefit Ekzekutiv të Institutit të Kosovës për Administratë Publike), përkatësisht nenin 130 pika 1 dhe 2 të këtij ligji ku përcaktohej se: "Ankimimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin. Në rastin e mosveprimit të administratës (mos nxjerrjes së aktit dhe heshtjes së plotë), ankimi administrativ bëhet brenda 60 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës për fillimin e procedimit administrativ.." si dhe në kundërshtim me dispozita e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (ligj i aplikueshëm në kohën e parashtrimit të kërkesës së datës 28.01.2019), përkatësisht nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 të këtij ligji ku përcaktohet se: "1.Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"...4 Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ" andaj, mbi këtë bazë rrjedhë së ankesa e ankueses për kompensimin në mënyrë retroaktive është e pabazuar.

Po ashtu, Kolegji lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, thekson faktin së Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023 dhe si rrjedhojë me nenin 45 paragrafi 2 është përcaktuar se: " ...2.Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji, rrjedhimisht me hyrjen në fuqi të kiji ligji pagat dhe kompensimet përtej pagës bazë rregullohen dhe realizohen vetëm në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Theksuar si me sipwr, e në mbështetje të nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.703 /2023

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Institutin e Kosovës për Administratë Publike; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.